



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

interesuara për t'u rihapur pasi kanë marrë njoftimin me vonesë në lidhje me këtë proces. Besoj dakord dhe përfaqësuesit e Qëndresës. Atëherë janë prezent kandidatia dhe përfaqësuesi i saj, nga palët e tjera? Zonja?

**Znj. Edona Tafa:** Edona Tafa.

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit! Atëherë e riçelim hetimin administrativ. Fjala për kandidaten Majlinda Angoni ose përfaqësuesin dhe pastaj për zonjën Edona Tafa.

**Z. M. Legisi:** Po, faleminderit zoti kryetar. Në lidhje me rastin në hetim kemi marrë të gjitha njoftimet dhe shkresat e Komisionerit, e mbrojtura prej meje i ka kthyer një përgjigje me numër protokolli 1558 datë 04.03.2022, ku ka sqaruar se lidhur me denoncimin e raportuar në portalin zyrtar të KQZ-së, në një spot elektorale të postuar në profilin e saj zyrtar ku është pasqyruar dhe imazhi i Qendrës Shëndetësore Rrethina. Duam të sqarojmë pak rastin se si ka ndodhur. Zonja Angoni dhe zonja Edona Tafa kanë një njohje të mëparëshme dhe i është kërkuar që të bëhet një kompozim i tillë në video dhe në audio për shkaqe të fushatës elektorale. Sigurisht që nuk është kërkuar dhe nuk është bërë asnjëherë kjo video sikur referohet në rastin e denoncuar brenda orarit zyrtar të punës. Kjo do të thotë se nuk ka cënuar në thelb asnjë lloj interesi publik apo shëndetësor të ndonjë individi apo grup individësh të zonës ku është bërë video dhe kërkojmë që ta theksojmë. Edhe nga materialet e dosjes së procedimit administrativ rezulton se video është bërë në orën 17:00. Vizitat pranë kësaj qendre shëndetësore përfundojnë në orën 13:00 zoti Kryetar dhe po të marrim dhe orarin zyrtar që është ora 16:30 nuk ka më asnjë vizitë. Në këtë kuptim edhe përfshirja e mjekes në këtë spot nuk ka sjellë asnjë lloj dëmi. Ndër të tjera nuk kemi as përdorim të burimeve njerëzore në kuptim të ligjit dhe kohës zgjedhore.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

Nuk ka një përdorim të detyruar zoti Kryetar. Çështja se si kemi ardhur te publikimi, te Qendra Shëndetësore “Rrethina” sikurse e ka sqaruar edhe më përpara zonja Angoni ka qenë një problem me kompozimin. Personi që është marrë me këtë kompozim nuk i di mirë ndalimet ligjore dhe këtu ka rrjedhur ajo që është përdorur nga dënoncuesi. Në këtë kuptim I nderuar, ne kërkojmë rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Nuk kemi përdorim të aseteve dhe të burimeve njerëzore në kuptim të ligjit, neni 91 pika 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor, faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Fjala për Ju!

**Znj. Edona Tafa:** Përshëndetje, unë doja të sqaroja vetëm dy pika. Në rradhë të parë me zonjën Angoni siç u ritheksua unë njihem përmes angazhimit tonë në çështje sociale dhe bashkëpunimit që kemi patur që vijon prej vitesh. Në lidhje me pretendimin tuaj që në video është xhiruar dhe pjesmarrja ime që ka qenë në orarin zyrtar të punës, ju siguroj që ajo video është xhiruar pas orarit zyrtar të punës duke respektuar detyrimet e mia kontraktuale si profesioniste të cilat përfundojnë në momentin e mbarimit të orarit zyrtar. Përtej atij orari besoj se është mëse e lejueshme si profesioniste e lirë për të dhënë mbështetjen time gjithmonë pa përdorur asnjë aset, pa cënuar shërbimin tim ndaj zonës që unë mbuloj dhe ofroj shërbim shëndetësor dhe mbi të gjitha duke respektuar orarin zyrtar, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Prapësime nga ana e përfaqësuesve të Qëndresës në lidhje me sa u pretendua nga subjektet pjesëmarrëse në këtë shqyrtim?

**Znj. T. Kurti:** Për sa kemi deklaruar edhe më përpara, prapësimet tona dhe pasi njihemi sërish me deklaratimet tuaja abuzive me pa djeninë e ligjit nga ana e grupit

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

të xhirimit, nuk ju shkarkon ju nga përgjegjësia. Ju keni përgjegjësinë ligjore dhe ligji e shpreh në mënyrë eksplicite neni 91, i Kodit Zgjedhor që në asnjë mënyrë, nuk mund të përdoren asete dhe burime publike në funksion të kandidatëve, koalicioneve zgjedhore. Përsa i referohemi të gjithë debatit, ajo çfarë na intereson edhe nga ana jonë askush nuk mund të ketë çelsin e Qendrës Shëndetësore dhe të marrë e të bëjë një xhirim. Kush e vuri në dispozicion këtë Qendër Shëndetësore që është një aset publik dhe ju lejojë që të xhironin në mënyrë shumë të lehtë dhe pa pengesa? Po ashtu në referim të përdorimit të burimeve njerëzore, avokati tha përdorim i detyruar dhe nuk mund t'i referohemi vetëm përdorimit të detyruar. Ju po pranoni që zonja në fjalë, ka ardhur për shkak të njohjeve, është vetofruar për të bërë një spot në një aset publik. Gjë që sigurisht është totalisht në ndalim, sepse ajo është mjeke e asaj qendre shëndetësore. Po ashtu ajo deklaroi hapur mbështetjen e saj për zonjën Majlinda Angoni dhe në referim të nenit 6, pika 3 punonjësit të administratës shtetërore gjatë orarit të punës ose në mjediset e punës i ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Po, shkurt edhe një herë!

**Z. M. Legisi:** Ligji mbron interesin publik. Pra, në rastin konkret është cënimi i interesit të banorëve për të marrë mjekime dhe për të mos u angazhuar në aktivitete të tilla. Ne parashtruam dhe nuk u provua as nga pala tjetër që ka patur një cënim të interesit të këtyre njerëzve, pra që këta njerëz nuk kanë marrë kujdes shëndetësor etj etj. Shërbimi mbaron në orën 13:00 në atë zonë. Kaq kisha!

**Z. I. Celibashi:** Kam përshtypjen se përfaqësuesit e Qëndresës nuk kanë asgjë në lidhje me qasjen e zonjës kundrejt kandidatës, është zgjedhja e asaj në pikëpamje të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

preferencës politike por, sjellim në vëmendje që ajo e ka bërë këtë, mund ta bëjë dhe publike nuk ka asnjë lloj ndalimi, por e ka bërë këtë duke shfrytëzuar një aset publik siç është vendi i punës. Kjo ishte apo jo?

**Z. M. Qirinxhi:** Po, e drejtë!

**Znj. Majlinda Angoni:** Ne e kemi pezulluar menjëherë spotin pasi kemi parë se montazhieri kishte vënë aty Qendra Shëdetësore dhe nuk është shfaqur në asnjë nga rrjetet sociale.

**Znj. T. Kurti:** Spoti vijon të jetë në faqen tuaj zyrtare.

*(Përfaqësuesit e Qëndresës Qytetare e hapin spotin nga smartfoni me zë dhe figurë)*

**Z. M. Legisi:** Këtë mund ta merrni si provë?

**Z. M. Qiraxhi:** Për atë kohë sa u tha që është hequr dhe nuk ndodhet as në rrjetet sociale, unë mendoj se gjithkush mund të shohë në rrjete sociale dhe është aty. Ne në thelb nuk jemi duke kërkuar, nuk po pretendojmë se ëshë cënuar mungesa e shërbimit të qytetarëve përse i përket orarit zyrtar të punës. Ne jemi në situatën ku një aset publik pasuri e të gjithëve është vendosur aty për të dëmtuar garën në fushatën elektorale siç e kanë parashikuar partitë politike kur kanë marrë vendim apo ligjvënësit kur kanë ndryshuar Kodin Zgjedhor. Kjo do të thotë se ata nuk kanë menduar që ne duhet t'i hyjmë debatit a është dëmtuar apo jo dikush në këtë garë, por e kanë prezumuar të ndaluar në themel. Kjo do të thotë që ky aset nuk duhet të përdoret në fushatë elektorale, pa i hyrë shpjegimit nëse i shkon dikujt apo dikujt

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

tjetër favori. Kështu që në këtë situatë ne jemi përpara një skeme të qartë, që një aset është përdorur nga një garues për kandidat të Bashkisë Shkodër.

**Z. I. Celibashi:** E fundit për ju!

**Z. M. Legisi:** Edhe ne kthim përgjigje është pranuar zoti Kryetar që është çështje pakujdesie. Pra, nuk është se ka patur një mohim. Ne këtu po kërkojmë që të themi se nëqoftëse ekziston si shkelje ajo është thjesht formale, sepse jemi përpara një rasti ku është një qendër shëndetësore dhe nuk ka pasur asnjë cënim të interesit publik për sa i përket funksionit të kësaj qendre. Pra, këtë duam të theksojmë.

**Z. M. Qiraxhi:** Ne jemi këtu edhe për këtë shkelje formale.

**Z. I. Celibashi:** Mirë keni prova të tjera që kërkonit të administrohen veç atyre që keni prezantuar në seancat e mëparëshme?


**Znj. T. Kurti:** Nëse është e mundur ta dimë si është vënë në dispozicion kjo qendër shëndetësore, pasi ka edhe persona të tjerë përgjegjës, siç do të ishte drejtori i kësaj qendre shëndetësore, si i është vënë në dispozicion grupit të xhirimit?

**Z. M. Legisi:** Ju e kërkonit që ta pohojmë nga ana jonë apo doni të merrni ndonjë provë? Nëse kërkonit të merrni ndonjë provë, duhet bërë kërkesë. Prova nuk kemi.

**Z. I. Celibashi:** Jo nëse keni ndonjë pohim se provë nuk kemi!

**Z. M. Legisi:** Jo, nuk kemi, vetëm ato ç'ka deklaruam!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

**Z. I. Celibashi:** Mirë faleminderit! E përfundojmë hetimin administrativ, fjala e fundit për pretendimet e fundit nga përfaqësuesit e Qëndresës!


**Znj. T. Kurti:** Në vijim të pretendimeve tona, kërkojmë konstatimin e shkeljes nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe marrjen e masave administrative ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste dhe zonjës Majlinda Angoni, gjithashtu dhe ndaj mjekes zonjës Edona Tafa.

**Z. I. Celibashi:** Po, përfaqësuesi i kandidatës?

**Z. M. Legisi:** Faleminderit i nderuar, ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova, për të dy subjektet e mbrojtura prej meje, zonjës Angoni dhe zonjës Tafa faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Ju keni për të shtuar? Jo, faleminderit. Mirë atëherë e mbyllim seancën në lidhje me këtë çështje dhe për këtë shpallim vendimin ditën e enjte.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





28.06.2022  
Ora 11:52

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare” ndaj zonjës Emirjana Sako, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës, zotit Arben Ahmetaj Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.*

**PJESËMARRJA :**


• **KQZ**

- |   |  |
|---|--|
| <b>1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve</b> | <b>Z. Ilirjan Celibashi</b>  |
| <b>2.Stafi KQZ:</b>                         | <b>Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja</b>  |
| • <b>Qëndresa Qytetare</b>                  | <b>Znj. T. Kurti, Z. M. Qiraxhi</b>  |
| • <b>Të tjerë:</b>                          | <b>Bashkia Durrës (Z. V. Manushi)<br/>Zv/kryeministri (Znj. S. Llatja)</b> |

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zonjës Emirjana Sako, kandidate për kryetar të Bashkisë Durrës, zotit Arben Ahmetaj Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave si dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

Atëherë janë prezent përfaqësuesit e organizatës, nga Bashkia e Durrësit nga kandidatja për kryetare e Bashkisë së Durrësit, zonja Sako?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

**Z. V. Manushi:** Vangjel Manushi, jurist pranë Drejtorisë Ligjore të Bashkisë Durrës, me autorizim të përfaqësueses.


**Z. I. Celibashi:** Nga Ministri i Shtetit?

**Znj. S. Llatja:** Salora Llatja, këshilltare politike e Zv/Kryeministrit dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Reformat.

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit! Hapim shqyrtimin administrativ. I japim fjalën përfaqësuesve të Qëndresës Qytetare për të prezantuar pretendimet e tyre, faleminderit!

**Znj. T. Kurti:** Faleminderit i Nderuar! Përsa i përket rrethanave të faktit që i përkasin këtij denoncimi, ne kemi denoncuar aktivitetin e datës 3 mars në Njësinë Administrative Manëz, ku kandidatit e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për kryetare bashkie e shoqëruar nga Zv/Kryeministri dhe Ministri për Rindërtimin me pjesëmarrjen e banorëve të zonës, përfitues nga ky investim promovojnë zonën e re të banimit në Manëz ku kanë përfunduar njësitë e banimit. Gjatë këtij takimi siç vihet re nga statusi në profilin personal të kandidatit dhe të zotit Ahmetaj, në këtë takim është bërë promovimi i investimit vendor në atë zonë duke mbështetur dhe promovimin e objekteve të rindërtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore. Ky aktivitet vjen vetëm tre ditë para zgjedhjeve të pjesshme të datës 6 mars, i cili shkel hapur nenin 91, pasi nuk mund të përdoren apo të vihen në mbështetje të kandidatëve apo partive politike, ose koalicioneve, burime ose asete publike. Burimet në këtë rast edhe në kuptim të burimeve njerëzore në referim të nenit 142 të Kodit Civil.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

Gjithashtu në referim të nenit 6 pika 3, punonjësve të administratës shtetërore i ndalohen të përdorin të mira publike, funksione ose veprimtari shtetërore, materiale njerëzore me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje. Në këtë rast zoti Ahmetaj përse është pranuar edhe nga shkresat zyrtare gjendet në cilësinë e ministrit pranë kandidates vetëm 3 ditë para zgjedhjeve. Siç vihet re nga statusi por edhe nga videot e publikuara edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Rindërtimit, nga profili zyrtar i zotit Ahmetaj thuhet se “sot së bashku me Anën në zonën e re të banimit të Manzës ku kanë përfunduar 9 pallate, rreth 230 apartamente që në ditët në vijim do të marrin në dorë çelësat”. Element ky që dallon qartazi dhe elementin e premtimeve elektorale. Ndër të tjera do të dëshironim të ndaleshim edhe në praninë e shtuar të banorëve ku në kuadër të këtij inspektimi ministri së bashku me kandidaten ngjiten në apartamentet e banorëve dhe u thonë shprehimisht ta gëzoni, do të merrni çelësat etj., etj. Video këto që vijnë të jenë të publikuara. Po ashtu në ndërfaqen e raportimeve rezulton një takim i raportuar nga Bashkia Durrës i cili i referohet një takimi me titull inspektim në terren në Manzë, i cili nuk i përmbush kriteret e nenit 92 të Kodit Zgjedhor për sa i përket elementëve të afatit 5 ditor të raportimit në ndërfaqe. Për sa më sipër kërkojnë konstatimin e shkeljeve nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore ndaj Zv/Kryministrit dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin zotit Arben Ahmetaj, ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste dhe zonjës Emirjana Sako.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesi i kandidates për kryetar Bashkie Durrës, zonjës Sako.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

**Z. V. Manushi:** Atëherë shkurtimisht lidhur me pretendimin e subjektit Qëndresa Qytetare, dua të sqaroj një fakt. Kryetarja e Bashkisë Durrës në pozicionin e kryetares së bashkisë dhe jo si kandidate ka shkuar të inspektojë zonën e Manzës që është një zonë në rindërtim. Natyrisht ka qenë i mbështetur nga Ministri i Ndërtimit dhe Zv/Kryeministri Ahmetaj. Është një procedurë rutinë që titullari i institucionit vazhdon dhe ndjek punimet në zonat në rindërtim në funksion të nenit 23 të ligjit për vetëqeverisjen vendore në funksion të kryetarit të bashkisë jo si kandidat për kryetar bashkie, por si administrator ekzekutiv. Pra, vëren se si po shkojnë punimet a kanë ecur, natyrisht ka pasur prezencë të qytetarëve. Prezenca e qytetarëve nuk do të thotë që janë njoftuar nga titullari i institucionit, apo nga media. Prezenca e qytetarëve është e ndjeshme në atë zonë, sepse rindërtimi është një problem madhor jo vetëm për Durrësin, por për pjesën më të madhe të qyteteve që janë goditur nga tërmeti. Kjo nuk do të thotë që është bërë një promovim i punës së bashkisë. Prezenca e Zv/Kryeministrit patjetër që është në funksion të rindërtimit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesja e Ministrit të Shtetit!

**Znj. S. Llatja:** Faleminderit! Prezenca e Zotit Ahmetaj ka qenë në cilësinë e të ftuarit ashtu siç ftohet në kuadrin e të qenurit ministër i rindërtimit në 11 bashki të cilat janë duke zbatuar programin e rindërtimit. Dua të citoj pak pjesën e banorëve. Manza është një njësi administrative me një sipërfaqe prej 43.25 km katror, me një popullësi totale 11681 banorë dhe tek kjo dua të citoj pak pjesën e rindërtimit. Rindërtimin në Manzë e kemi me 133 banesa individuale, kemi ndërtimin e rrjetit të ri rrugor dhe infrastrukturës. Përbëhet nga zona e re e zhvillimit që janë 9 blloqe banimi dhe akomodohen 226 familje. Besoj se ky është një numër mjaftueshëm për të pasur banorë në momentin kur shkon Zv/Kryeministri dhe Ministri i Rindërtimit në pjesën

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

e inspektimit. Kjo nuk do të thotë që ne lajmëruam banorë, as që janë detyruar banorët të marrin pjesë. Por duke qenë se janë vetëm 226 familje në apartamente mendoj se janë mjaftueshëm për të qenë prezent, për t'u interesuar për problematikat e tyre, të cilët do të marrin një apartament në dorëzim. Kështu që në lidhje me këtë pjesë të ankesës dhe pretendimit, unë mendoj që ne kemi qenë brenda rregullave në cilësinë e të ftuarit për të inspektuar një zonë që është pjesë e programit, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Keni prapësime në lidhje me sa u pretendua nga palët? Shkurt, ju lutem!


**Znj. T. Kurti:** Po, përsa i përket kryetares së bashkisë apo kandidates, tre ditë para zgjedhjeve është shumë e vështirë ta ndash nëse je aty si kandidate apo si kryetar potencial i mundshëm. Ndër të tjera, ju thatë që aty banojnë banorë, por në video është shumë e qartë që apartamentet që vizitoheshin nuk ishin të banuara, madje pronarët e atyre apartamenteve jetojnë jashtë shtetit, kështu që është një provë e qartë.

**Znj. S. Llatja:** Nuk thashë se banojnë banorë..., nuk mund të deformohet ajo çfarë thashë...

**Z. I. Celibashi:** Zonjë një minutë! Me leje!

**Znj. T. Kurti:** Unë as nuk po e interpretoj, por thjesht po citoj informacione nga pamjet publike që gjenden edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Rindërtimit. Kështu edhe përsa i përket inspektimit është një term... Nëse i referohemi inspektimit si term

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*


do të thotë që inspektojmë njësitë që po ndërtohen me ndërtuesit, inxhinjerët dhe jo banorët duke parë hap pas hap çdo apartament dhe ministri duke ju thënë “ta gëzoni”. Kështu që ne besojmë fort në të gjitha faktet që i referohemi dhe që kemi paraqitur. Aty është bërë promovimi i objekteve të rindëtuara në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore e cila përbën një veprimtari të ndaluar. Prezenca e ministrit të shtetit si përfaqësuesi më i lartë i administratës shtetërore siç është ministri, implikon dhe favorizon kandidatin tre ditë para zgjedhjeve.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Po!

**Z. V. Manushi:** Atëherë, kundërshtoj pretendimet e Qëndresës Qytetare, sepse kryetari i bashkisë ka ndjekur procedurën ligjore që duhet të ndjekë një administrator duke inspektuar rindërtimin. Rindërtimi është një proces shumë i vështirë dhe ka nevojë për praninë e titullarit të institucionit. Kjo nuk ka të bëjë me faktin tre ditë apo pesë ditë para zgjedhjeve. Nuk kemi të bëjmë me një promovim të punës së Bashkisë Durrës, por kemi të bëjmë me një inspektim të ndërtimit se si shkojnë punimet dhe aty nuk mund të bëhet takimi vetëm me zbatuesin e punimeve, me inxhinjerët, për ata bëhet takimi! Por, nuk ndalon dot qytetarët të cilët janë jashtë mase të ndjeshëm lidhur me përfundimin e punimeve. Nuk e imagjinoj dot se si janë kërkesat në institucion, “kur do të përfundojnë punimet, kur do të sistemohemi”? Ju duhet të merrni në konsideratë edhe këtë pjesë. Pra, nuk kemi të bëjmë me takim promovues, kemi të bëjmë me një inspektim në terren. Ky ka qenë vetëm një inspektim punimesh në qytetin e Manzës, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, përfaqësuesia e Ministrit të Shtetit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

**Znj. S. Llatja:** Atëherë termin inspektim nuk mund ta vendosë Qëndresa Qytetare se kë duhet të ftojme në pjesën e inspektimit, apo jo, e para. E dyta, pjesa e raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është bërë tre ditë para nga Bashkia Durrës, duke qenë se në momentet kur Kryeministri nuk është prezent, Zv/Kryeministri bëhet automatikisht bëhet Kryetar i Bordit të Krizës së Emergjencës. Ne disa ditë më parë e kemi refuzuar si ftesë, për arsye se agjenda ka qenë shumë e ngarkuar. Ne nuk kemi pasur mundësi që të gjejmë një hapësirë kohore. Ne e kemi konfirmuar katër ditë para dhe është bërë tre ditë para raportimi nga Bashkia Durrës. Kjo nuk ka ardhur si pjesë e promovimit të kandidatës, as si pjesë e promovimit të partisë. Ka ardhur si pjesë e promovimit të programit të rindërtimit, një nga programet më të mira në këto tridhjetë vite, mendoj unë. Nuk është e nevojshme të qeshësh... dhe pjesa tjetër është që ne kërkojmë prova. E para, për banorët e ardhur me detyrim sipas Qëndresës Qytetare që nuk janë pjesë e qytetit dhe për përdorimin e makinave të cilat janë pjesë e institucionit, të kryeministrit nga ana e stafit të Zv/Kryeministrit. Në dijeninë time Zv/Kryeministri në atë takim ka qenë i shoqëruar vetëm nga shoferi i tij me një makinë personale, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po nëse ka qenë aktiviteti në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij, përse duhet të shkonte me makinë personale?

**Znj. S. Llatja:** E kisha te pjesa që nuk ka qenë stafi te asnjë nga makinat, me asnjë makinë të institucionit shtetëror.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Që të mos kalojmë në përsëritje, janë të qarta dhe pretendimet tuaja dhe prapësimet e palës tjetër. Provat që kërkon që të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

administrohen në këtë shqyrtim administrativ, të tjera veç atyre që i janë bashkëlidhur denoncimit tuaj, keni?

**Znj. T. Kurti:** Jo, janë të qarta!

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Nuk keni kërkesë për prova të tjera! Përfaqësuesi i kryetares së bashkisë dhe kandidates për kryetare bashkie, kërkon që të merren dhe administrohen prova të tjera?

**Z. V. Manushi:** Jo!


**Z. I. Celibashi:** Nuk kërkon? Ju përfaqësuesja e Ministrit të Shtetit?

**Znj. S. Llatja:** Po kërkoj prova nga Qëndresa Qytetare për banorët të cilët qenkan lajmëruar dhe kanë ardhur prezent në takim nga stafi, apo nga Ministri i Shtetit për Rindërtim dhe Reformat, njëkohësisht Zv/Kryeministri, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Qëndresa nuk ka prova të tjera për të prezantuar?

**Z. M. Qiraxhi:** Ne nuk disponojmë prova të tjera, përveç atyre që kemi paraqitur dhe duket e tepërt që të përdoret kjo gjuhë, për aq kohë sa ne kemi me pamje vizuale një inspektim i cili edhe nga ana teknike une jam me profesion arkitekt, nuk ka lidhje me inspektimin për sa i përket çështjeve teknike të rindërtimit. Ndërkohë që deklarata për makinën personale me të cilën Zv/Kryeministri përdor për të promovuar një nga arritjet më të mëdha siç e tha dhe këshilltarja e tij që është rindërtimi, duket disi absurde. Ndërkohë për sa i përket frymës së ligjit është

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

pikërisht që të mos kemi ato ngjarje të cilat provojnë presionin e qytetarit që të marrë pjesë në një aktivitet, kur bëhet fjalë për ditë të fushatës. Prandaj dhe autoritetet të cilat kanë vendosur për të ndryshuar kodin, e kanë ndryshuar në themel, që të mos kemi nevojë për të vërtetuar barrën e ngritjes së qytetarëve me forcë, apo pa forcë. Kjo veprimtari quhet e ndaluar që në themel dhe ne nuk kemi nevojë që të diskutojmë a janë me forcë apo janë me dëshirë.

**Z. I. Celibashi:** Pra, nuk keni prova të tjera? Faleminderit!

**Z. M. Qiraxhi:** Jo, faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë i japim fundit hetimit administrativ, fjala e fundit për përfaqësuesit e Qëndresës!

**Znj. T. Kurti:** Për sa i referohemi prapësimeve tona, kërkojmë konstatimin e shkeljeve nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe marrjen e sanksioneve administrative në referim të normave ligjore ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Durrës, zonjës Emirjana Sako, Partisë Socialiste dhe zotit Arben Ahmetaj, si Ministër i Reformës dhe Rindërtimit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, Përfaqësuesi i kandidates dhe i kryetares së bashkisë, përfundimisht!

**Z. V. Manushi:** Kërkojmë rrëzimin e pretendimeve të subjektit Qëndresa Qytetare si të pabazuar në ligj dhe në prova!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.28.06.2022*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesja e Ministrit të Shtetit!

**Znj. S. Llatja:** Kërkojmë rrëzimin e pretendimit nga Qëndresa Qytetare.

**Z. I. Celibashi:** Mirë e mbyllim hetimin dhe shqyrtimin administrativ në lidhje me këtë çështje. Shpallja e vendimit ditën e enjte në orën 11! Faleminderit seanca publike mbyllet, ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

